

L I G J
Nr.7517, datë 8.10.1991

**PËR PUNËSIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Duke u bazuar në të drejtën e njeriut për ushtrimin e lirë të punës e të profesionit, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Shtetasi shqiptar i aftë për punë, me kërkesën e tij pranë organit kompetent shtetëror, ka të drejtë të punësohet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Të drejtën e punësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk mund të ushtrojnë :

- a) personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç,
- b) personat që kanë për të kryer shërbimin ushtarak,
- c) personat e dënuar penalisht si dhe ata kundër të cilëve ka filluar ndjekja penale deri në përfundimin e saj,
- ç) personat, ndaj të cilëve institucioni, ndërmarrja, organizata ose individ i ngrenë pretendime për detyrime materiale deri në shqyrtimin përfundimtar të tyre dhe në shlyerjen e plotë të detyrimit,
- d) personat që kanë detyrime familjare të pazgjidhura të parashikuara në Kodin e Familjes me përjashtim të rastit kur japin garanci ligjore për përmbushjen e detyrimeve,
- dh) të gjithë pjestarët e forcave të armatosura,
- e) personat të cilëve me vendim të gjykatës u është hequr zotësia për të vepruar.

Neni 3

Punësimi jashtë shtetit bëhet në bazë të legjislacionit të punës të Republikës së Shqipërisë dhe të vendit ku bëhet punësimi.

Neni 4

Punësimi jashtë shtetit mund të bëhet në grupe ose në mënyrë individuale, mbi bazën e kontratës që lidhet me punëdhënësin e huaj. Kontratat mund të jenë kolektive ose individuale.

Neni 5

Afati i punësimit është nga një muaj deri në pesë vjet. Ky afat mund të zagjartet mbi bazën e nenshkrimit të një kontratë të re.

Neni 6

Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit lidhen marrëveshje qeveritare me vende përkatëse.

Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale drejton, organizon e kontrollon punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në varësi të këtij Komiteti, ngrihet e funksionon Zyra e Emigracionit me degët e saj në shtete të huaja, të cilat mbrojnë interesat e shtetasve shqiptarë të punësuar në to.

Neni 7

Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale lidh marrëveshje punësimi me organet përkatëse ose personat juridikë a fizikë të shteteve të tjera. Lejohet kontrata individuale e punësimit.

Zyra e Emigracionit me degët e saj në shtetet e huaja, si dhe personat juridikë a fizikë vendas, lidh kontrata punësimi dhe ndjekin plotësimin e tyre, duke vënë në dijeni Komitetin e Punës dhe të Përkrahjes Sociale.

Neni 8

Kushtet e punës e të jetesës, pagat, ndihmat, paaftësia e përkohshme dhe e përhershme në punë, pensionet, si dhe llojet e tjera të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, transportimi i punonjësve dhe çështje të tjera të kësaj natyre, rregullohen në bazë të marrëveshjeve të kontratës.

Neni 9

Zyra e Emigracionit u siguron personave që do të punësohen jashtë shtetit një informacion të plotë për legjislacionin dhe rregullat e punës e të jetesës të vendit përkatës.

Neni 10

Koha e punës jashtë shtetit i njihet e vlefshme punonjësit për efekt pensioni, kur ai kthehet në atdhe me zgjidhjen e kontratës dhe kur paguan kuotën mujore të sigurimeve shoqërore të caktuara me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Shtetasit që punësohen jashtë shtetit paguajnë një taksë mbi të ardhurat mujore.

Neni 12

Regjistrimi dhe zgjedhja e punonjësve që do të punësohen jashtë shtetit bëhet mbi bazën e kërkesave (testeve) të punëdhënësit të huaj, të ballafaquara me aftësitë fizike, përvojën profesionale dhe certifikatën e kualifikimit teknik të tyre nga seksionet e punës e të përkrahjes sociale të komiteteve ekzekutive të rretheve e të rajoneve ku bëhet dhe regjistrimi në bashkëpunim me Zyrën e Emigracionit të Komitetit të Punës e të Përkrahjes Sociale.

Kur personat juridikë dhe fizikë vendas lidhin kontrata punësimi me punëdhënësit e huaj, bëjnë vetë zgjidhjen e punonjësve që do të punësohen jashtë shtetit.

Neni 13

Shpenzimet për përgatitjen e përcjelljen e dokumentacionit të nevojshëm përballohen nga vetë personi që kërkon të punësohet jashtë shtetit, në bazë të një tarife të përcaktuar nga Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Neni 14

Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe ministritë e institucionet e tjera qëndrore, ka të drejta të ngrejë kurse kualifikimi me shkëputje nga puna për punonjësit që do të punësohen jashtë shtetit.

Shpenzimet për aftësim profesional e ndërrim profesional për shtetasit që nuk janë në marrëdhënie pune, përballohen nga shteti, kurse për ata që janë në marrëdhënie pune, nga vetë

personat.

Neni 15

Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla të hollësishme në zbatim të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.60, datë 12.10.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia.